



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.02.2021, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Xhevit Bushaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Korab Lita, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Suzana Topi, Arben Elezi,

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Reme Lala, Ylli Shehu.

Të ftuar:

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomise

Xhoana Agolli – Drejtoreshë e Menaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomise

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e ditës së sotme siç e kemi njoftuar.

Në këtë mbledhje kemi për shqyrtim vetëm një çështje, atë “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë” për të cilin jemi komision për dhënie mendimi.

Nga qeveria për të mbrojtur projektligjin janë zëvendësministria e Financave Adela Xhemali, zoti Gentian Opre, drejtor i Analizës dhe Programit Buxhetor, si dhe zonja Xhoana Agolli, drejtoreshë e Menaxhimit të Buxhetit, ndërsa nga Ministria e Shëndetësisë është zëvendësministria Mira Rakacolli dhe sekretarja e Përgjithshme, Geraldina Prodani.

Para se të fillojmë mbledhjen do të verifikojmë edhe një herë praninë: Anastas Angjeli, Arben Elezi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Roland Xhelili, Xhavit Bushaj, Evis Kushi nuk është, Reme Lala nuk është, Senida Mesi nuk është, Vullnet Sinaj nuk është, Edlira Hyseni, Krenar Rryçi, Artur Roshi, Korab Lita nuk është, Ylli Shehu nuk është, Artemis Dralo, Suzana Topi është.

Faleminderit të gjithëve!

Vazhdojmë mbledhjen sipas këtij rendi dite që theksova.

Kush do ta mbrojë projektin nga përfaqësuesit e qeverisë?

Zonja Rakacolli është këtu?

Geraldina?

Geraldina Prodani – Po, përshëndetje!

Anastas Angjeli – Kush do ta mbrojë? Ju, apo zonja Rakacolli?

Geraldina Prodani – Në fakt, është planifikuar zonja Rakacolli. Një minutë sa ta verifikoj dhe do të kthehem ta prezantoj unë, nëse zonja Rakacolli e ka të pamundur.

Anastas Angjeli – Zonja Rakacolli, më dëgjoni? Hapeni mikrofonin, ju lutem!

Mira Rakacolli – Tani po, se pata një problem me internetin dhe nuk ju dëgjoja fare. Ju kërkoj ndjesë!

Anastas Angjeli – Nuk ka problem.

Fjala për të prezantuar këtë marrëveshje.

Mira Rakacolli – I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sjell përpara këtij komisioni për të diskutuar ratifikimin e një marrëveshjeje të KM-së dhe qeverisë së Republikës së Turqisë në lidhje me një donacion në fushën e shëndetësisë dhe konkretisht bëhet fjalë për një donacion, për një spital rajonal, që do të ndërtohet në qytetin e Fierit dhe që do t'i shërbejë të gjithë rajonit të Jugut. Parimi bazë i politikave shëndetësore të qeverisë sonë ka qenë dhe mbetet gjithmonë ai që quhet parimi i mbulimit universal, që do të thotë sigurimi (*nuk kuptohet*)...shërbimi shëndetësor cilësor të aksesueshëm dhe të përballueshëm për të gjithë, sa më afër vendbanimit, duke pasur gjithmonë qytetarin në qendër. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve është bërë i qartë plotësimi i nevojave të qytetarëve sa më afër vendbanimit, mjafton të përmendim këtu programin e rikonstruksionit të 300 qendrave shëndetësore, apo ndryshimet rrënjësore që janë bërë në infrastrukturë e pothuajse të gjitha spitaleve rajonale dhe atyre universitare, njëkohësisht shërbimet cilësore të munguara dhe të ofruara tashmë jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe të tjera, siç është shërbimi i hemodinamikës, që përpara 8 vitesh sigurohej vetëm në orë të caktuara, vetëm në QSUT, vetëm paradite dhe në bazë të një planifikimi. Tashmë jo vetëm që bëhet 24 orë pranë kësaj qendre universitare, por njëkohësisht ofrohet për qytetarët e Veriut në qytetin e Shkodrës dhe për qytetarët e Jugut në Fier, si dhe një sërë shërbimesh të tjera të cilat janë bërë tashmë të mundura për t'u arritur në një kohë sa më të shkurtër, qoftë edhe me ndryshimin rrënjësor që i është bërë Qendrës Kombëtare të Urgjencave dhe numrit të shtuar të flotës së ambulancave, që tashmë në kohë shumë të shkurtër gjenden pranë qytetarëve, të cilët kanë nevojë, duke u siguruar një shërbim cilësor në kohën e duhur.

Natyrisht që ndryshimet janë të mëdha, por jemi të ndërgjegjshëm që akoma nuk plotësohen të gjitha ashtu si qytetarët kanë nevojë dhe ashtu siç janë pritshmëritë dhe objektivat tona. E rëndësishme është që disa shërbime vazhdojnë të mbeten të ofruara vetëm në QSUT në Tiranë, ose në disa spitale të tjera të alokuara në Tiranë, duke e bërë pak të vështirë marrjen e shërbimeve nga qytetarët që nuk jetojnë në Tiranë. Për këtë arsye qeveria turke bëri një donacion për një spital, i cili do të ketë 115 shtretër, i ndërtuar në qytetin e Fierit, por që qëllimi i tij është t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të rajonit të Jugut me shërbime të munguara në të gjitha spitalet e këtij rajoni. Pra, bëhet fjalë për një spital, që do të ofrojë shërbime të lidhura me ndërhyrje cilësore në të gjitha fushat e mjekësisë interne, pra kardiologji, neurologji, endokrinologji, hematologji gastrointestinale etj, do të shërbejë në hemodinamikë jo vetëm për ato që bëhen sot në qytetin e Fierit, pra vetëm për ndërhyrjet diagnostikuese dhe vendosjen e stendeve, por edhe të ndërhyrjeve më të komplikuar sesa ato. Njëkohësisht do të bëhet edhe një qendër trombolize, që sot ofrohet vetëm në qytetin e

Tiranës, po ashtu do të ofrohen edhe shërbime kirurgjikale, që, në sajë edhe të aparaturave me të cilat do të jetë i pajisur ky spital (sot jo vetëm që nuk bëhen në spitalet rajonale, por disa prej tyre mund të mos bëhen edhe në QSUT), bëhet e mundur që një pjesë e pacientëve të jenë të detyruar t'i marrin këto shërbime jashtë kufijve të Shqipërisë.

Është një spital, unë e thashë shumë shkurt për shkak të kohës që kemi në dispozicion, i një niveli mjaft të lartë dhe që do të bëjë t'u shërbehet me një cilësi shumë të mirë qytetarëve të të gjithë Jugut, duke i bërë ato edhe të arritshme.

Çka është edhe më e rëndësishme është fakti që qeveria turke është zotuar që këtë spital ta bëjë rekord, brenda tre muajve, dhe të gjithë e dimë që punimet për këtë spital kanë filluar dhe duket që ky afat kohor patjetër që do të arrihet, por ky angazhim i qeverisë turke patjetër që kërkon edhe një angazhim nga pala shqiptare dhe ky angazhim është i përshkruar në këtë marrëveshje.

Ky spital jo vetëm që do të ndërtohet krejtësisht nga pala turke, por edhe do të pajiset me të gjitha, qoftë me mobilimet, qoftë edhe me aparaturat dhe për këtë arsye kërkohet, për shkak të faktit që është donacion dhe të kohës së shkurtër të ndërtimit, që të gjithë mallrat dhe gjërat që duhen për ta ndërtuar këtë spital, të cilat vijnë nga jashtë, kryesisht nga Turqia, të kenë procedura doganore të lehtësuara dhe njëkohësisht të jenë të përjashtuara nga taksat dhe tatimet.

Njëkohësisht, edhe ato pajisje ose materiale, të cilat do të blihen në Shqipëri, në këtë marrëveshje kërkohet që të jenë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Nga ana tjetër, në këtë marrëveshje ruhet e drejta që qeveria turke të zgjedhë, të kontraktojë për shërbimet që kanë të bëjnë me këtë spital, kompani turke me kontrata të paracaktuara dhe të përzgjedhura nga vetë ajo dhe njëkohësisht, nëse quhen të nevojshme, është ajo që do të kontraktojë edhe kompani të tjera vendase ose të huaja.

Pra, shkurtimisht, këto janë pikat kryesore që përmban marrëveshja, të cilën ftoj që, pas diskutimit, ta miratoni për faktin se do ta ndryshojë shumë nivelin e shërbimit të qytetarëve shqiptarë, sidomos në drejtim të cilësisë dhe të afërsisë me vendbanimin, sidomos për të gjithë banorët e regjionit të Jugut.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Rakacolli!

Sipas procedurës, fjalën e ka zonja Dhima, si relatore.

Antoneta Dhima - Faleminderit shumë zoti kryetar!

Falënderoj zëvendësministren Rakacolli për prezantimin e projektligjit!

Në cilësinë e relatores zakonisht bëj falënderime për qeverinë, si dhe ministrave të saj lidhur me punën, angazhimin dhe ofrimin e shërbimeve sidomos në situatat e përmytjeve, tërmetit dhe pandemisë si dhe investimeve shumë të rëndësishme në territore.

Edhe sot nuk dua t'i kursej falënderimet për Kryeministrin Rama, i cili ka një rol të padiskutueshëm dhe shumë të rëndësishëm në investimin që qeveria turke aktualisht po bën për ndërtimin e Spitalit Rajonal Memorial në qytetin e Fierit, si dhe qeverinë turke dhe presidentin e saj, zotin Erdogan, për këtë dhuratë që i ka bërë jo vetëm Fierit, por gjithë Shqipërisë.

Gjithashtu, falënderoj për angazhimin dhe mbështetjen e treguar që në ditët e para të fillimit të investimit, ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonjën Balluku, ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjën Manastirliu, administratën e bashkisë Fier, institucionet qendrore në nivel vendor, si dhe banorët e zonës të cilët vunë në dispozicion tokën për një investim kaq të rëndësishëm, jo vetëm për Qarkun e Fierit, por për gjithë Jugun e vendit, pasi edhe vendosja e tij është bërë e tillë që të jetë e aksesueshme edhe nga qytetet e Jugut të vendit.

Në momentin e parë, kur u diskutua ndërtimi i këtij spitali, një pjesë e qytetarëve dhe politikanëve ishte skeptikë, si dhe u paragjykua dhe nuk u besua se do të bëhej realitet. Po kjo gjë, në fakt, nuk ndodhi, pasi ka qenë data 23 janar kur filloi puna për ndërtimin e tij dhe prej asaj dite e deri sot puna aty vazhdon intesivisht me objektivin që brenda 3 muajve të përfundojë ndërtimi i tij.

Në këto vite qeverisje Kryeministri Rama dhe qeveria shqiptare kanë pasur dhe kanë mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, sidomos për tërmetin dhe pandeminë, njëri prej të cilëve është edhe qeveria turke, e cila aktualisht po ndërton dhe do të sigurojë pajisjet mjekësore dhe pajisjet e tjera për Spitalin Rajonal Memorial në Fier, një investim sa i rëndësishëm, aq edhe i domosdoshëm krahasuar me kushtet në të cilat funksionon spitali aktual, të cilin kam pasur fatin ta drejtoj për një periudhë kohe dhe e njoh shumë mirë infrastrukturën e tij.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë” është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, synon që qeveria e Republikës së Turqisë t'i dhurojë vendit tonë një spital me 150 shtretër, si dhe pajisjet mjekësore, pajisjet, materialet dhe orenditë e nevojshme.

Në kuadër të këtij donacioni, pala turke do të caktojë personelin e kujdesit shëndetësor gjatë fazës së tranzicionit të spitalit. Ministria e Shëndetësisë e Turqisë do të ofrojë këshillim për palën shqiptare. Ministrinë e shëndetësisë të të dyja vendeve do të nënshkruajnë një protokoll të veçantë për funksionimin e përbashkët të spitalit.

Pala shqiptare do të mbështesë palën turke për realizimin e projektit të ndërtimit dhe mobilimit të Spitalin Rajonal Memorial të Fierit, duke i krijuar lehtësitë e nevojshme kompanisë së kontraktuar nga pala turke.

Këto lehtësi përfshijnë përjashtimin nga të gjitha taksat dhe tarifatat, si dhe lehtësimin nga të gjitha procedurat doganore, të importit dhe të taksimit gjatë transferimit të të gjitha mallrave, pajisjeve mjekësore e pajisjeve të tjera, orendive dhe materialeve të ndërtimit nga Turqia në vendin tonë. Spitalin Rajonal Memorial Fier do të plotësojë të gjitha standardet e cilësisë sipas legjislacionit shqiptar.

Furnizimi brenda vendit i të gjitha mallrave e shërbimeve për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit, deri në datën e dorëzimit të tij palës shqiptare, përjashtohet nga TVSH. Gjithashtu, mallrat, materialet dhe pajisjet që do të importohen nga pala turke për këtë spital përjashtohen nga detyrimet doganore, taksat e tjera dhe TVSH-në në import.

Pala shqiptare do të lehtësojë edhe procedurat për dhënien e lejes dhe licencës për Ministrinë e Shëndetësisë së Turqisë apo kompaninë e kontraktuar prej saj.

Për të mundur hyrjen në fuqi të marrëveshjes dhe fillimin e punës në një kohë sa më të shpejtë, projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje propozohet të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar. Kjo do të ndihmojë në realizimin e projektit në një afat mjaft të shkurtër.

Marrëveshja është nënshkruar më 2 shkurt 2021 dhe në shtojcën 1 të marrëveshjes janë paraqitur pajisjet dhe orenditë e nevojshme që duhen për arredimin e këtij spitali.

Për sa u përket efekteve financiare, marrëveshja krijon lehtësitë e nevojshme për palën turke përmes përjashtimeve nga taksat, tarifatat dhe procedurat doganore për të gjitha materialet e pajisjet për ndërtimin dhe furnizimin e spitalit rajonal të Fierit.

Ajo që duhet të theksohet është fakti se këto lehtësira janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe krijojnë mbështetjen e nevojshme për donatorin. Ndërtimi dhe pajisja e spitalit është një investim shumë i rëndësishëm për vendin tonë, veçanërisht në kushtet aktuale të vijimit të pandemisë shëndetësore COVID-19. Ky spital do të ofrojë një

shërbim shëndetësor të kualifikuar dhe me teknologji të lartë mjekësore për të gjithë rajonin e Jugut. Ai do të rrisë kapacitetet spitalore rajonale, gjë të cilën e tha edhe zëvendësministrja, dhe do të mundësojë shërbimin spitalor përmes shpërndarje së pacientëve në spitale të ndryshme. Projektligji duhet të shqyrtohet normalisht nga Kuvendi sa më shpejt, me qëllim që t'i hapim rrugë vazhdimit të punimeve dhe ndërtimit të tij brenda afatit tremujor. Si banore e qytetit të Fierit, e vlerësoj shumë të rëndësishëm këtë investim jo vetëm për qytetin e Fierit dhe qytetarët e këtij qyteti, por edhe për mjekët dhe infermierët, të cilët do të punojnë dhe do të ofrojnë një shërbim me standarde dhe shumë cilësor jo vetëm për qarkun e Fierit, por edhe për Jugun e vendit.

Prandaj, të nderuar kolegë dhe kolege deputete të këtij komisioni, ju ftoj ta miratojmë këtë marrëveshje, e cila i hap rrugë një investimi sa të rëndësishëm aq edhe të domosdoshëm, të paktën në kushtet e pandemisë së COVID-19.

Shume faleminderit, zoti kryetar, që ma besuat mua relatimin e këtij projektligji!

Anastas Angjeli – Si nga Fieri që je, mendoj se të takonte.

Faleminderit, zonja Dhima!

Janë disa deputetë që kanë kërkuar fjalën për pyetje: zonja Topi, zoti Roshi, zonja Hyseni dhe zoti Rryçi.

Përpara se t'u jap fjalëve anëtarëve të komisionit për të bërë pyetjet e tyre, kam unë disa pyetje. Do të doja vëmendjen e Gelardinës dhe të Nikos, a do të ketë ndonjë dokument tjetër lidhur me këtë marrëveshje, apo është ky i vetmi dokument? A do të ishte me vend të kishim vlerën e këtij donacioni në këtë marrëveshje, apo do të jetë në një marrëveshje tjetër? Nëse është donacion, a do të kalojë ky donacion në buxhetin e shtetit, a i jepet buxhetit të shtetit? Si do të dokumentohet, si do të vlerësohet?

Marrëveshja shoqërohet me një listë të mallrave, të cilat nuk kanë çmim. A do të ishte me vend të kishin çmim? Si do të kalojnë në doganë, pavarësisht se nuk do të paguajnë doganë, me çfarë dokumenti, si do të vlerësohen? A do të ketë, siç thotë ndryshimi në fund, një akt dorëzimi të spitalit, të kolaudimit të tij, të vlerësimit të tij dhe do të bëhet me këtë, apo do të përdorni ndonjë mënyrë tjetër? Me një fjalë, a keni pasur ndonjëherë ndonjë rast tjetër? A ka ndonjë rregull sesi është vepruar? Këto ishin pyetjet që kisha, duke e vlerësuar shumë këtë marrëveshje, por do të flas përsëri në fund.

Fjalën e ka zonja Topi për pyetje.

Suzana Topi – Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje të gjithëve!

Spitali i Fierit është një investim mjaft i rëndësishëm në fushën e shëndetësisë dhe unë dua ta falënderoj qeverinë turke për këtë dhurim!

Në relacion thuhet se Republika e Turqisë do të caktojë personelin e kujdesit shëndetësor, pyetja është: stafi i spitalit do të jetë kryesisht turk, apo do të jetë miks?

Pyetja e dytë ka të bëjë me administrimin e spitalit, për sa kohë qeveria turke do ta administrojë spitalin? Kur do t'i dorëzohet Republikës së Shqipërisë?

Pyetja e tretë ka të bëjë me tokën ku po ndërtohet spitali. Aty e dimë që janë rreth 12 familje, të cilat kanë tokën në pronësi: a ka rënë dakord qeveria shqiptare në lidhje me shpronësimet dhe kur do të bëhet dëmshpërblimi i këtyre pronarëve?

Anastas Angjeli – Po, zoti Roshi.

Ju lutem, hapeni mikrofonin, se nuk dëgjoheni!

Artur Roshi – Kam dy pyetje, zoti kryetar. Njërin prej tyre ma morët ju, por sërish do t'i bëj të dyja. Për sa kohë është menduar funksionimi i tij, pra është i përkohshëm, apo i përhershëm? Sepse, duke parë strukturën, mobilimin e tij të duket si një spital portabël.

Pyetja e dytë: pse pala turke ka këtë urgjencë për ta mbaruar 3 muaj? Çfarë halli ka Turqia në këtë mes?

Anastas Angjeli – Kemi ne, se kemi koronën.

Artur Roshi – Nuk ka lidhje.

Në relacion thuhet se i sjellim të gjitha këto, pasi Turqia është shprehur se do ta mbarojë për 3 muaj. Halli këtu nuk është i Turqisë, por yni. Nëse do të bëjë një gjë, a nuk duhet bërë një marrëveshje okulte, sepse edhe trafikantët i bëjnë marrëveshjet më me dinjitet dhe jo kështu fshehurazi dhe jotransparente. Kjo është ideja.

Anastas Angjeli – Edlira, ju lutem, pyetjet!

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Në fakt, Suzana i përmbloodhi pyetjet e mia, prandaj më mbetet të bëj një pyetje shtesë. Nëse pas kësaj faze transitore, që parashikohet të menaxhohet në periudhën e ndërmjetme (dua të di sa kohë, muaj, vite parashikohet të jetë menaxhimi tranzitor i bërë nga pala turke), do ta konfirmojë veten një spital shtetëror me shërbime që ofrohen gratis nga qytetarët, apo parashikohet një formë e ndërmjetme midis privatit dhe shtetit?

Pyetje tjetër, që nuk e di nëse u tha: a do të jetë një spital i përshtatur edhe për COVID-in për përballimin e emergjencës, në të cilën ndodhemi, apo është vetëm për shërbime të tjera përtej COVID-it?

Falënderime për këtë mundësi që i jepet shëndetësisë nga pala turke!

Anastas Angjeli – Zoti Rryçi, për pyetjet.

Krenar Rryçi – A dëgjohem?

Anastas Angjeli – Po, dëgjoheni më mirë se sa çdo ditë tjetër.

Mos e mbyllni mikrofonin!

Krenar Rryçi – Jam dakord, ashtu si dhe kolegët e mi.

Kam dy pyetje. A kemi ndonjë ndryshim tjetër në lidhje me këtë, apo janë përmbushur të gjitha detyrimet financiare me këtë marrëveshje? A do të kemi ndonjë marrëveshje tjetër shtesë?

Në lidhje me personelin, mjekët shqiptarë, që do të punojnë aty, do të trajtohen njësoj si mjekët turq, apo do të ketë ndryshime edhe në lidhje me pagesat?

Anastas Angjeli – Faleminderit, Krenar!

Meqenëse nuk ka pyetje tjetër, atëherë fillojmë me përgjigjet nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Kush do të përgjigjet, ju lutem?

Gelardina Prodani – Përhëndetje! Do të përgjigjem unë, pasi zonja Rakacolli duhet të shkojë te Komisioni i Ligjeve, ku po prezantohet e njëjta projekt-marrëveshje.

Në lidhje me shqetësimin nëse do të ketë ndonjë dokument tjetër, i cili do të shoqërojë ndërtimin e spitalit të Fierit, ashtu sikundër prezantohet edhe në këtë projekt-marrëveshje, bëhet fjalë për një marrëveshje të firmosur nga qeveria turke dhe nga qeveria shqiptare. Këtu përfundon e gjithë korniza e parashikuar për ndërtimin e spitalit të Fierit.

Për sa i takon vlerës, ajo do të jetë e afirmuar kundrejt të gjitha faturave që do të na vihen në dispozicion, e cila do të bëjë të gjithë vlerën e investimit, që do të kontabilizohet dhe do të futet në kontabilitetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Për sa i takon stafit, ashtu sikurse shprehet edhe në marrëveshje, do të kemi një periudhë tranzicionit, ku ky spital do të menaxhohet nga stafi turk dhe nga stafi i personelit shëndetësor shqiptar, derisa modeli për t'u aplikuar në këtë spital, që do të dakordësohet nga të dyja palët, do të transferohet plotësisht në palën shqiptare.

Për sa i takon stafit të personelit turk, ai do të paguhet nga qeveria turke, ndërsa personeli shqiptar do të paguhet kundrejt pagesës që kemi ne në Republikën e Shqipërisë. Spitali do të jetë publik, spitali do të jetë i përhershëm, jo i përkohshëm.

Për sa i takon tjetrës, në lidhje me procedurat e përshpejtuara të këtij spitali, në fakt kjo është një sfidë e qeverisë turke për ndërtimin e spitalit në një kohë rekord, në një periudhë tremujore, qeveria shqiptare po ndjek të njëjtin ritëm. Çdo gjë e kemi në mënyrë të përshpejtuar. Kemi marrë përsipër që të mos ketë asnjë vonesë nga administrata shqiptare në lidhje me ndërtimin dhe sigurimin e spitalit.

Pra, kjo është arsyeja pse kemi propozuar që kjo projekt-marrëveshje të kalojë në mënyrë të përsheptuar. Ashtu siç e keni parë, puna në kantier po ecën me hapa shumë të mëdhenj, dhe besoj se brenda një muaji e gjysmë do ta kemi gati spitalin.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Niko, ke ndonjë gjë?

Niko Lera – Përshëndetje, kryetar!

Nuk kisha ndonjë problem të veçantë. Ndërhyrja jonë ka qenë vetëm që formulimi i paragrafit të përjashtimeve të ishte i saktë. Pra, ndërtimi i këtij spitali duhet të jetë i lirë nga taksat. Kjo është kërkesa e qeverisë turke. Nuk duan të përballojnë edhe taksa në Shqipëri, për ndërtimin e këtij objekti. Pikërisht, prandaj po ratifikohet marrëveshja në Kuvend, në mënyrë që të prevalojë mbi ligjet vendase.

Formulimi është i saktë. Në atë kohë e kërkoja, sepse duhej të shtohet edhe një fjali tjetër këtu, ku thotë se përjashtohen nga TVSH-ja blerjet e brendshme, që bën pala turke. Këtu mund të lindë një problem me shitësit. Pra, do të sjellin nga importi paletat, pajisjet e të tjera, dhe kjo është zgjidhur me këtë marrëveshje, që janë të përjashtuara. Do të ketë edhe disa blerje të brendshme. Për shembull, do të blejnë hekur, fjala vjen, mund të blejnë çimento. Problemi është që në bazë të kësaj marrëveshjeje, ata do t'i marrin pa TVSH, sepse e thotë vetë marrëveshja. Por subjekti ngrihet dhe thotë: po mirë, po TVSH, që unë e kam paguar në blerje, vetë do ta mbaj si barrë? Prandaj, aty ku thoshte se blerjet e brendshme janë të përjashtuara nga TVSH, duhej shtuar një frazë, që do të ishte: “të cilat i lejojnë shitësit të drejtën e kreditimit të TVSH-së”.

Fatkeqësisht, nuk e ndryshojmë dot këtë marrëveshje.

Artur Roshi – Niko, i marrin po të njëjtët njerëz, mos u bëj merak, ata të tërmetit, që e kanë të përjashtuar, kështu që oligarkët i kanë ato.

Anastas Angjeli – Mos ndërhyini pa leje, ju lutem! Ju lutem, mos ndërhyini pa leje!

Niko.

Niko Lera – Gjithsesi, nuk krijon problem, sepse do të interpretohet në kuptimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare të veçantë, që e ka të përcaktuar se ky investim duhet të jetë totalisht i lirë nga taksat. Duke qenë i tillë formulimi, atëherë ne do të interpretojmë që furnizimet që i bëhen këtij janë furnizime pa TVSH, jo furnizime të përjashtuara. Pra, do t'i konsiderojmë furnizime pa TVSH, dhe ta zgjidhim këtë handicap që po diskutojmë së bashku.

Anastas Angjeli – Meqenëse është e pamundur të ndryshojmë marrëveshjen...

Suzana Topi – Kryetar, më fal, por unë nuk i mora përgjigjet e dy pyetjeve.

Anastas Angjeli – Të mbarojmë dhe këtë.

Niko, meqenëse është e pamundur të ndryshojmë marrëveshjen, ju takon juve dhe Ministrisë së Shëndetësisë ta zgjidhni me akt nënligjor çështjen e interpretimit, që pika kaq e marrëveshjes, që thotë se duhet të jenë të lirë nga taksat, presupozon edhe këtë çështje.

Ka edhe dy pyetje të bëra nga Suzana, një për...

Suzana Topi – Jo, ju faleminderit, kryetar! Ju thashë se nuk mora përgjigjet e dy pyetjeve nga përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë, në lidhje me administrimin...

Anastas Angjeli – Po pra, ato po përsërisja, pyetjet e tua.

Suzana Topi – Në rregull!

Anastas Angjeli – Dymbëdhjetë pronarë, që jetojnë në atë tokë do të shpronësohen...

Suzana Topi – Jo, në lidhje me administrimin, për sa kohë, sipas afatit?

Anastas Angjeli – Cila është periudha e tranzicionit?

Gelardina Prodani – Periudha e tranzicionit është gjashtëmuajore, gjë për të cilën është rënë dakord midis dy qeverive. Domethënë, sapo jepen në dorë çelësat e spitalit, gjashtë muaj së bashku.

Anastas Angjeli – Zana, hape mikrofonin, të lutem!

Suzana Topi – Po, faleminderit, kryetar!

Pas gjashtë muajve, spitali do të merret në administrim nga qeveria jonë?

Gelardina Prodani – Spitali do të administrohet nga qeveria shqiptare qysh ditën e parë, por menaxhimi do të ketë në staf personel mjekësor edhe mjekë e infermierë të personelit mjekësor turk.

Anastas Angjeli – Edlira, prapë?

Edlira Hyseni – Jo, një pyetje që më vjen natyrshëm, meqenëse gjashtë muaj është periudha e tranzicionit, a nuk kemi nevojë për një rishikim të buxhetit? A nuk ka nevojë Ministria e Shëndetësisë për fonde shtesë, nëse do të ketë personel shtesë, që do të jenë pjesë e këtij spitali të ri? Nuk është nevoja për rishikim buxhetor në lidhje me fonde plus në Ministrinë e Shëndetësisë për përballimin e kësaj prurje të re?

Gelardina Prodani – Në momentin që struktura e spitalit do të jetë e dizenuar, në momentin që të gjitha shërbimet do të jenë të vendosura, patjetër që do të ketë një buxhet të dedikuar për spitalin e Fierit, spitalin memorial të Fierit. Më pas kjo do të shikohet dhe, në bazë të faturës që duhet të shikojmë kundrejt periudhës të vitit që ka mbetur, do të shikojmë ku do t'i gjejmë fondet. Mund t'i gjejmë fondet brenda sistemit të shëndetësisë për rialokim,

që mund të jetë një rialokim i brendshëm, ose mund të kërkojë më pas një rishikim apo marrje nga fondi rezervë. Pra, do të shikohen mënyrat se ku do të financohet. Patjetër që do të ketë buxhet shtesë, pra duhet të ketë një buxhet të dedikuar për spitalin ri që po krijohet.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Besoj se pati një sërë pyetjesh dhe përgjigjesh, deri shteruese, të çështjeve që u ngritën. Në qoftë se ka njeri tjetër ndonjë gjë për të shtuar apo për të diskutuar, pa dyshim mund të vazhdojmë dhe më pas kalojmë në votim.

Vetëm zoti Roshi e ka kërkuar fjalën.

Fjala për zotin Roshi.

Artur Roshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Për të mos u zgjatur, pavarësisht se toka nuk u është marrë me dëshirë atyre që u është marrë për ta ndërtuar këtë spital, sepse ne kemi parë kronika nëpër media të ndryshme që gati u është marrë me zor dhe pronarët nuk janë dakord, por kjo është një çështje tjetër, le të futemi te thelbi i kësaj marrëveshjeje. Është një marrëveshje e ardhur me urgjencë që mbas saj në njëfarë mënyre fshihet diçka që nuk shkon. Sigurisht, nuk fshihet kjo pjesa e euforisë së qeverisë për arritjen që ka për ndërtimin e spitalit, por ka një gjë, përderisa ne nuk kemi vlerën e spitalit, është një gjë krejt spontane e ndërtuar partizançe, me aksion, ashtu sikundër Partia Socialiste e bën gjithë qeverisjen e vendit: hidh uji e hidh miell. Në fakt, nuk e dimë faturën përfundimtare, nuk dimë sa mjekë do të ketë, nuk mund të bëjmë një parashikim edhe të asaj që tha zonja Hyseni, të alokimit në buxhet të pagës së mjekëve e kështu me radhë. Ajo që mua më shqetëson është kjo: në qoftë se ne marrim një donacion nga një vend, i cili nga Perëndimi shikohet si një vend autokratik dhe jodemokratik, pyetja që lind është kjo: pse e bëjnë këtë?! E bëjnë për t'i bërë karshillëk Greqisë për konfliktet që ka Turqia me Greqinë?! Unë nuk besoj se na i ka për borxh grekët që t'u bëjmë një gjë të tillë, sepse na kanë mbështetur në çdo hap të integritit të vendit tonë në Bashkimin Europian.

Së dyti, kujt ia bëjmë Bashkimin Europian, Perëndimit?! Nuk besoj se ne kemi fuqi për t'i bërë Perëndimit karshillëk nëpërmjet Turqisë.

Së fundi, në qoftë se ne do të potencojmë, sepse ky spital është thjesht një dhuratë që i bëhet kryeministrit për t'u potencuar dhe, në njëfarë mënyre, për të rrëmbyer një mandat të tretë, ko është me pasoja për jetën e shqiptarëve, sepse tregon mbështetjen dhe orientimin e qeverisë. Nëse qeveria e sotme do të marrë një mandat të tretë, ne do të shkojmë drejt Perëndimit, apo do të shkojmë osmanizmit? Unë them se rruga jonë është e përcaktuar drejt Perëndimit. Kështu që edhe marrëveshja është tërësisht okulte pa asnjë detaj, nuk është fare transparente, madje janë për të qeshur ato mjetet, si sirtarët me xhama, që shoqërojnë

relacionin. Prandaj, për këto që thashë më sipër, vota ime është kundër, sepse është një donacion enigmatik, me vlerë të papërcaktuar dhe jotransparente.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Besoj se pyetjet dhe diskutimet ishin shteruese për çështjen që kemi në rendin e ditës. Nuk besoj se një marrëveshje e arritur midis Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë për ndërtimin e një spitali përcakton orientimin politik euroatlantik të Shqipërisë apo një qëndrim drejt një destinacioni tjetër. Politikat investuese në Shqipëri kanë qenë dhe janë të hapura për të gjitha shtetet, janë të mirëpritura. Ndërtimi një spitali është një mbështetje që i jepet sektorit të shëndetësisë në Shqipëri, i cili, për hir të së vërtetës, edhe pse është mbështetur jashtëzakonisht në këta 8 vjet dhe më parë, ka ende shumë nevoja për të përballuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe është rasti që, meqenëse jepet një mundësi e tillë, të shtohen përpjekjet për t'u shërbyer qytetarëve për nevojat që kanë. Pa dyshim, të gjitha sugjerimet që u bënë këtu, konsiderohen nga të dyja ministritë: nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave që kontrata të zbatohet me përpikëri, dhe, natyrisht, të bëhen të gjitha vlerësimet e mundshme që ky donacion të kontabilizohet nga Ministria e Shëndetësisë, duke u reflektuar edhe në buxhetin e shtetit pas marrjes në dorëzim të aktit të kolaudimit dhe inventarizimit të të gjithë procesit të investimit dhe të pajisjeve që do të pajisin këtë spitali, cili do të jetë rajonal dhe në shërbim të qytetarëve. Duke ju falënderuar të gjithëve, kalojmë në procesin e votimit të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”

E hedhim në votimin në parim projektligjin. Kush është pro? Abstenim? 1 abstenim. Kundër? 1 kundër.

Me një votë kundër dhe një votë abstenim miratohet në parim kjo marrëveshje.

Neni 1. Kush është pro? Abstenim? Zonja Suzana abstenon. Kundër? Kundër është zoti Roshi.

Miratohet

Neni 2. Kush është pro? Abstenim? Zonja Suzana abstenon. Kundër? Zoti Roshi është kundër.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 1 abstenim. Kundër? 1 kundër.

Me një votë kundër dhe një votë abstenim miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”.

Faleminderit!

Në postën elektronike do t’ju vëmë në dispozicion materialet dhe do t’ju njoftojmë për mbledhjen e ardhshme.

Ditë të mbarë!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti